



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 18.12.2015, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Shaip Muja, Srdjan Popović dhe Emilija Redzepi.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.11.2015,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2015,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
5. Te ndryshme ;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shtesa të propozuara për rendin e ditës : për formimin e një nënkomisioni për

demarkacionin e Kosovës me Malin e Zi (**Shaip Muja**) dhe njoftimin e GP rreth punës për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektionin bujqësor (**Adem Salihaj**).

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua duke shtuar vetëm njërin pikë të **Adem Salihajt**, ndërsa pika e propozuar nga **Shaip Muja** u shndërrua në **kërkesë të miratuar** nga Komisioni për Kryesinë e Kuvendit : Të kërkohen shkresat dhe dokumentacioni nga Qeveria e Kosovës përkatësisht nga Komisioni Shtetëror për demarkacionin e Kosovës me Malin e Zi pasi që është në kompetencën e këtij komisioni sipas Rregullores së Kuvendit por edhe sipas Rezolutës së Kuvendit nga 25.6.2015 sipas së cilës nuk kontestohet kompetenca e këtij komisioni.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.11.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor

Kryesuesi Fikrim Damka njoftoi komisionin për të dhënat e dorëzuara nga stafi i komisionit rreth raportit se çka ka punuar komisioni gjatë këtij viti, duke shtuar se ky raport i plotëson kushtet për miratim ngase paraqet pasqyrën reale të punës së komisionit i cili ka punuar aq sa është dërguar materiali nga Qeveria që do të thotë se Qeveria nuk ka dërguar asnjë projektligj përkundër strategjisë së hartuar në fillim të vitit dhe përkundër faktit se komisioni dy herë ka ftuar ministrat përkatës për të sqaruar pse nuk sjellën ligjet e premtuara për vitin që po kalon. Megjithatë Komisioni ka miratuar një projektligj, vazhdoi, të hartuar nga Komisioni dhe në përfundim është edhe një tjetër që poashtu është hartuar nga Kuvendi e jo nga Qeveria. Duke elaboruar më tutje kryetari shtoi se komisioni gjatë punës ka ngritur edhe disa çështje tjera të rëndësishme për fushveprimtarinë e komisionit, nuk është pajtuar me një raport të Qeverisë-MMPH për mjedisin por ajo megjithatë është miratuar nga mbledhja plenare, megjithëse siç tha ai, është dashur të ftohet paraprakisht Ministri për njoftime bazike, gjithashtu nuk është miratuar një raport vjetor nga ZRRUK për shkak të mungesës së personit zyrtar kompetent (Drejtori dhe zv. Drejtori) që njofton komisionin. Propozoi të miratohet raporti vjetor. **Adem Salihaj** gjithashtu u pajtua me konstatimin se ky komision i ka kryer detyrat që i takojnë dhe me sukses ka përmbyllur këtë vit, shprehu gatishmërinë që edhe mbikëqyrjen e ligjit për inspektionin bujqësor, ku është ai kryesues, të përfundojë derisa të filloi sesioni pranveror pasi që nevojiten edhe ca informata shtesë nga kompetentët, falënderoj geupin punues me stafin për punën e kryer gjatë mbikëqyrjes së këtij ligji. **Murat Hoxha** ishte i mendimit që raporti përfshinë elementet e duhura për një dokument publik, përndryshe i ceku disa punë që është dashur të bëhen sidomos gjatë shqyrtimit të projektligjit për shërbimet e ujit ku është dashur të dëgjohen edhe ca operatorë dhe palë të interesuar në një debat publik gjë që edhe kjo nuk prish imazhin e punës së bërë në këtë komision gjatë këtij viti. Ai kritikoi mosëshpenzimin e fondit të paraparë për punën e komisionit e cila është dashur të përdoret për terren më tepër dhe

për hartimin e planit të punës së komisionit, sidomos tani. **Emilija Redzepi** u pajtua dhe propozoi të shkohet për vizitë dhe të punohet kjo strategji, por **Kryetari Fikrim Damka** kundërshtoi ngase viti buxhetor është përmbyllur, ndërsa lidhur me diskutimin e z. Hoxha pohoi se ato punë që ceku ai është dashur të kryhen, mirëpo në anën tjetër komisioni ka pasur edhe urgjenca për të përfunduar ky ligj çka sipas mendimit të tij nuk ka dëmtuar përmbytjen që e ka, ngase ky ligj ka filluar të hartohet në legjislacionin e kaluar kur janë shtjelluar gjërat e nevojshme sa i përket ligjit në fjalë. **Emilija Redzepi** u pajtua me diskutime dhe shtoi se komisioni, sidomos grupi punues ku është angazhuar ajo, ka punuar me përkushtim duke u munduar që monitorimi i ligjit të jetë një lidhje e nivelit komunal me atë qendror dhe agjencitë e pavarura siç është AUV ku duhet më tepër angazhim. Fjalën e mori edhe drejtori prezent **Fehmi Hyseni** i cili njoftoi komisionin se plani i punës së komisionit bëhet sipas strategjisë së hartuar nga Qeveria që do të thotë se në fillim të vitit dërgohet kjo strategji e cila shërben komisioneve për të hartuar planet e punës, ai gjithashtu sqaroi propozimin e komisionit për të vazhduar punën gjatë javës në vijim, ngase kuvendi dje ka përmbyll punën e sesionit vjeshtorë, ndaj aktivitetet që bëhen më tutje janë pa efekt procedural derisa fillon prapë kuvendi sesionin pranveror gjatë muajit janar 2016. Ai tha se edhe sot nuk është dashur komisioni të punoj por me siguri kjo ka ndodhur për shkak se është caktuar mbledhja më herët.

Shaip Muja u ndërlidh me konstatimin e kryetarit i cili tha se komisioni ka refuzuar miratimin e raportit nga MMPH për gjendjen mjedisore 2015, dhe shtoi se miratimi nga mbledhja plenare e këtij raporti duhet të shpallet jovalid menjëherë posa të filloi punën kuvendi në sesionin pranveror, ngase nuk është respektuar rekomandimi i këtij komisioni funksional.

Kryetari Fikrim Damka përmbylli këtë pikë duke konstatuar pajtimin e komisionit me raportin vjetor të hartuar nga stafi – administrata i cili do të dorëzohet arkivit të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i projektligjit për zonën e rrezikuar të Obiliqit

Shaip Muja në cilësinë e kryesuesit të GP për këtë projektligj tha se komisioni në dispozicion i ka dokumentet që janë hartuar nga legjislacioni i kaluar (amendamentet etj), kurse në punën e këtij legjislacioni përkatësisht në GP ku është ai kryesues, ende duhet të plotësohen disa përgjegje në pyetje, pastaj të hartohen rekomandimet për mbledhje plenare. Së pari duhet shikuar a ka nevojë për ndryshimin e ligjit për minerale për çështjen e rentës rreth shfrytëzimit të mineraleve duke shfrytëzuar përvojat nga shteti i Çekisë, gjithashtu me MFE duhet të analizohet financimi i këtij ligji dhe eliminimin e këtyre problemeve financiare. **Fikrim Damka** u pajtua se ky projektligj ka implikime financiare dhe njoftoi kryesuesin se edhe Hani Elezit tani kërkon ligj të veçantë, mirëpo kryesuesi sqaroi se atje në Sharrcem duhet të sanohen kontaminimet në dy pika për çka GP u angazhua edhe një here në mars të vizitoi këtë kompani për të verifikuar premtimet e zyrtarëve përkatës, poçese edhe atëherë nuk ka rezultate do të vjen në shprehje kërkesa për mbrojtje mjedisore si zonë i veçantë i ndotur. Në përmbyllje **Shaip Muja** konstatoi se është e nevojshme involvimi i MZHE, MMPH dhe MFE për të përfunduar me sukses ky projektligj, ndërsa **Fikrim Damka** mbështeti kryesuesin e GP duke premtuar se do të mbahet një mbledhje me këta akter rreth projektligjit në fjalë. **Adem Salihaj** u angazhua që të epet fillimisht vlerësimi financiar me shkrim nga MFE ndërsa **Murat Hoxha** konstatoi se në bazë të vizitave të kryera është konstatuar progres mjedisor në punën e

këtyre kompanive që ndotin mjedisin, mirëpo nëse nuk mjafton ky progres në cilësi, duhet të ndërhyjmë me amendamente adekvate. **Shaip Muja** potencoi faktin se progresi duhet të konstatohet me ligj p.sh. çdo 5 vite e jo të jetë ligj i përhershëm.

4. Të ndryshme

Kryesuesi Fikrim Damka hapi diskutimin rreth pikës së shtuar dhe temave të ndryshme,

- **Adem Salihaj** fillimisht falënderoj GP dhe stafin për punën në përfundim e sipër rreth **monitorimit të Ligjit për Inspeksionin bujqësor** ku është bërë punë e madhe dhe janë vizituar 9 komuna dhe MB, janë mar informacione të nevojshme nga AUV, APK dhe MMPH, ndaj pritet siq tha ai të përfundoj GP me rekomandime deri në fillimin e punës së Kuvendit në janar. Ai tha se do të ishte kryer edhe tani kjo punë por në pritje është GP për ca informata shtesë nga Qeveria-ZKM.
- Pasi që në fillim të mbledhjes u miratua vendimi i Komisionit për të kërkuar nga Kryesia e Kuvendit dokumentacionin për demarkacionin e Kosovës dhe Malit të zi, u zhvilluan diskutimet si vijon : **Shaip Muja** insistoi që të formohet nënkomisioni ngase i takon këtij komisioni të shtjelloj çështjen në fjalë si kompetencë funksionale, për arsye se nuk është përmbyll kjo çështje për të dërguar rekomandim mbledhjes plenare, sugjeroi që të kërkohet dokumentacioni dhe të mbahet një mbledhje e komisionit, absurde është që të merret me këtë çështje presidentja e vendit ndërsa ata që janë kompetent vetëm të vërtetojnë, ai tha se nuk kupton qëndrimin e LDK për mosformimin e nënkomisionit. **Emilija Redzeqi** u pajtua me Shaip Mujën por theksoi nevojën e konsultimeve me GP ku është ajo-me PDK. **Murat Hoxha** theksoi realitetin e ri sipas së cilës tani Qeveria kërkon formimin e një komisioni me ekspert ndërkombëtar, ndaj posa të dërgohet në Kuvend kjo çështje mund të vjen në shprehje kërkesa në fjalë. Edhe **Adem Salihaj** ngjashëm insistoi dhe përsëriti qëndrimin e tij se pa ardhur në Kuvend ne vetëm mund të komplikojmë çështjen në fjalë. **Shaip Muja** konstatoi se opozita ka të drejt nëse ne nuk veprojmë në drejtimin e duhur dhe nuk ka nevojë askush të pret qëndrimet politike pasi që komisioni vepron i pamvarur.

Mbledhja përfundoi në orën 11,30.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka